

**FLIJA: VROJTIM ETNOGRAFIK**

ARSIM CANOLLI

Tiranë: Akademia e Studimeve Albanologjike

(2018, ISBN: 9789928289001

Prishtinë: Cuneus (2019, ISBN: 9789951602198)

Arsim Canolli, në vazhden e hulumtimeve në atë që ai e quan “kultura buknore” e Kosovës, ka publikuar së fundi monografinë “Flija: vrojtim etnografik” (Cuneus 2019). Në traditën e studimeve etnologjike, tematika e kulturës së ushqimit (apo kultura buknore), nuk është rrahur pothuajse fare nga studiuesit në Kosovë e Shqipëri. Etnologjia shqiptare është marrë më shumë me përshkrimin, klasifikimin dhe ruajtjen e dijeve dhe praktikave të ndryshme, sesa me interpretimin dhe studimin e tyre. Kjo mund të lidhet edhe me hamendësimin e shumë studiuesve se pjesa më e madhe e praktikave të kulturës buknore nuk janë konsideruar të denja për t’u ruajtur, sepse janë parë ose si të huaja, ose si primitive.

Monografia e Canollit, e rryer në interpretim antropologjik me bazë të qartë empirike, thyen tendencën e etnologjisë dhe e

kthen vëmendjen drejt dijeve e praktikave që ndeshen me kulturën e bukës. Studimi i tij është i bazuar në një hulumtim pothuajse dhjetëvjeçar dhe, në masë të madhe, është zhvillim i pikëpamjeve të ofruara në tezën e tij të doktoratës. Titulli i monografisë mund të jetë paksa hetues, sepse, në pamje të parë, duket sikur bëhet fjalë për një libër kulinarie për flinë si haje karakteristike e Kosovës. Por, lexuesi i vëmendshëm do ta vërejë se kemi të bëjmë me diçka më të gjerë. Megjithëse flija, si haje dhe si praktikë, është e vendosur në qendër, objekt i studimit është krejt gama e sjelljeve shoqërore dhe e praktikave kulturore që e karakterizojnë jetën e popullit të Kosovës në dimensione të ndryshme kohore dhe hapësinore. Në fjalët e vetë autorit, “flija është ‘nisërza’ dhe ‘sosërza’ e këtij rrefimi kulturor” (f. 20).

Në tetë pjesët që është i shtruar studimi, Canolli provon të rrokë një seri temash me interes për antropologjinë: lidhjen e njeriut të Kosovës me zjarrin e sofrën, ritin e festën, dhuratën e mikpritjen, gjininë, gastronominë e trashëgiminë, reliktn e mimetikën. Gjithnjë në kuadrin e kulturës buknore, autori diskuton edhe për katundin e “katunopinë”, diasporën e “sijashten”, shijen e shëndetin, odën e shtetin, traditën e rivitalizimin, të shenjtën dhe profanen, etiken e erotiken. Qëmtimin e kulturës së Kosovës përmes derës së vogël të bukës, Canolli e nis me diskutimin për zjarrin si “farëz e kulturës” (f. 70) dhe për gatimin si proces me prapavijë sa simbolike, aq edhe biologjike. Më tej, Canolli vazhdon me diskutimin e nocioneve të përkatësisë e origjinës dhe mënyrën se si këto mund të preken përmes venerimit të kujdesshëm të praktikave që zhvillohen përreth kulturës buknore. Ai e sheh flinë si njëfarë “mbijetoje” që ka ardhur deri në ditët tona si pak e ndryshuar. Ja pse autori arrin në përfundimin se përcaktimi i përkatësisë dhe origjinës së flisë (dhe shumë mbijetojave të tjera) është

pothuajse i pamundur në mungesë të dokumenteve të shkruara. Megjithatë, përtej ikjes nga diskutimi për përkatësinë e origjinën, Canolli thellohet në interpretim e analizë për kultin e diellit, ritualet e kalimeve, festat pagane e religjioze, në të cilat flija ka qenë dhe është e pranishme. Një nga konstatimet e rëndësishme është se kujtesa e vetme e popullit të Kosovës për festën e Shmarkut (Shën Markut) është e lidhur me qitjen e flijave.

Më tej, autori flet për konceptin e dhuratës në kuadër të kulturës buknore. Duke u bazuar në teoritë primare mbi dhuratën, ai vendos në përplasje dialogjike dy figura kolosale, si Malinowski e Mauss. Duke i shoshitur interpretimet e këtyre studiuesve, por edhe duke dhënë shembuj nga bashkëbisedimet e tij anekënd Kosovës, Canolli spekulon mbi natyrën reciproke të dhuratës si fenomen universal (f. 170). Madje, shkon edhe më tej, duke argumentuar se “dhurata e kthyer është themeli i paqes” (f. 175). Përveç diskutimit për dhuratën si normë shoqërore, autori sjell në pah studimet që vijnë nga antropologjia biologjike dhe potencon se impulsi për t'u

treguar e shpërfaqur (përmes dhënies së dhuratës) është veti gati universale njerëzore, e vulosur në sistemin kognitiv njerëzor përgjatë procesit të gjatë të evolucionit (f. 174). Në kuadrin e diskutimit për dhuratën si borxh, Canolli prek edhe konceptin e mikpritjes si një nga karakteristikat kryesore të traditës dokesore shqiptare. Edhe pse e konsideron flinë si “shenjë mikpritjeje” (f. 190), ai megjithatë nuk heziton të deklarojë se gjuha mikpritëse që bëhet rreth flisë është “krejt retorike” ndërsa arsyet për mikpritjen janë “krejt praktike” (f. 195).

Vëmendja që i kushtohet marrëdhënieve gjinore, të cilat dalin në pah në vrojtimin e kulturës buknore, është pjesë e rëndësishme e studimit. Duke folur për “gjinorëzimin” e bukës, Canolli vëren se aspekte të caktuara të përgatitjes dhe konsumit të bukës historikisht janë asociuar me njërën apo tjetrën gjini. Në këtë kuadër, autori diskuton për teorinë e promovuar nga antropologjia evolucioniste për “burrin gjahtar” dhe “gruan magjetore” (f. 214). Edhe këtu, ai dialogon me studiues nga të dy krahët e antropologjisë, nga ai kulturor e

social dhe nga ai biologjik, dhe vëren se studimet nga të dyja anët gjithnjë e më shpesh flasin për gërshtim të punës rreth bukës, duke iu ikur ndarjeve të supozuara dikotomike që bëhen nga studiues më radikalë të të dyja taboreve. Kështu, ai kritikon qasjen nga feminizmi radikal i pjesës së dytë të shekullit XX, qasje e cila e konsideron gjendjen patriarkale si “vulë historike”, që mund të shlyhet me revolucion shoqëror (f. 215). Për Canollin dallimet gjinore nuk janë vetëm procese shoqërore, por edhe historike e biologjik. Ndaj nuk heziton të theksojë se buka krijon edhe komplimentaritet, por edhe hierarki gjinore (f. 221) dhe se revolucioni shoqëror nuk mund t’i shlyejë dallimet biologjike (*Ibid*). Me finesë etnografike, Canolli diskuton edhe për gjuhën gjinorëzuese dhe objektivimin erotik të gruas flipjekëse, që është brumosur në marrëdhëniet përreth kulturës buknore në Kosovë (f. 229). Ai vëren se puna kulinare e grave në të kaluarën duket të ketë qenë kriter kryesor për krijimin e statusit të tyre përbrenda komunitetit farefisnor (f. 232).

Në pjesët e tjera Canolli ofron një pamje të komercializimit

të flisë në sferën e gastronomisë përmes dy koncepteve qendrore: “katunopisë” dhe “sijashtes” (f. 255). Gërshetimi i këtyre dy anëve, jetës fshatare të Kosovës dhe peizazhit kulturor evropian, siç vëren autori, ka bërë që sfera e gastronomisë të shihet si model për krejt kulturën e Kosovës, e cila po vjen duke u ngjizur në një kulturë mimetike që synon “të ruajë duke ndryshuar” (f. 264). Kultura mimetike (sijashtja) në njërin anë, dhe ajo e reliktit (katunopia) në anën tjetër, përbëjnë “binomin e botëkuptimit kulturor shqiptar” (f. 336) të Kosovës bashkëkohore, që shfaqet në impulsin për rivitalizim, arritje e ndryshim (apo, thënë në fjalorin buknor të Canollit, qërim, krasitje e tazllaitje). Kultura buknore e Kosovës, është pasqyra dhe mastari më i mirë i këtij impulsi për të ndryshuar duke ruajtur, ndërsa “flija është testament i kohës sonë” (f. 336).

Studimi i Canollit, sidomos në pesë pjesët e para, është jashtëzakonisht i pasur me përshkrime të thukëta të realitetit buknor të Kosovës. Pleq e plaka, burra e gra, djem e vajza, ndajnë me lexuesin përjetimet e së kaluarës, sfidat e të sotmes dhe

shpresën për të ardhmen. Të gjitha këto përsiatje ekzistenciale vijnë përmes derës së vogël të bukës, të cilën etnografi-antropolog ka mundur ta hapë me dedikim e autoritet. Në fakt, mund të themi se bashkëbisedimi i çlirët përbën boshtin metodologjik të studimit të Canollit, i cili duket se me qëllim i ka ikur prezantimit të informacionit si “të dhëna” të vjela nga bashkëbiseduesit e tij. Për këtë arsye, insistimi për t’iu referuar bashkëbiseduesve të tij përgjatë studimit si “subjekte” apo “informantë” nuk korrespondon me natyrën dialogjike të studimit, sepse vërehet qartazi se autori ka bërë hulumtimin përmes vrojtimit e bisedës së ngeshme e jo përmes vjeljes së “të dhënave” me anë të pyetësorëve që plotësohen brenda pak minutave.

Duhet përmendur që studimi ka disa problematika sa i takon botimit. Redaktimi i përsheptuar, forma paksa jopraktike e shpjegimeve referenciale, vendosja jo fort e kënaqshme e fotografive ilustrative (shumë nga të cilat janë mjaft domethënëse) dhe formati ndoshta i vogël për një libër aq voluminoz, janë disa nga këto.

Për ta përfunduar: “Flija” është studim holistik që nisat e

mbaron te kultura si konstrukt shoqëror dhe provon të ofrojë pikëpamje katërkëndore për qëmtimin dhe interpretimin e dijeve dhe praktikave njerëzore, të marra nga tradita studimore anglo-amerikane, me katër degët e mëdha të antropologjisë: sociale-kulturore, linguistike, biologjike, si dhe nga arkeologjia. Për më tepër, studimi i Canollit mund të konsiderohet si ndër të parët në gjuhën shqipe, që i vendos në sofrën e përbashkët qasjet nga dy perspektiva krejt të ndryshme përbrenda shkencave shoqërore: këtu rrihen, dialogojnë, pajtohen e përplasen qasjet më relativiste të antropologjisë sociale e kulturore

në njërën anë, me ato më universaliste të antropologjisë biologjike në anën tjetër. Mund të thuhet se me këtë studim, Canolli ka mbjellë farën e komunikimit ndërmjet këtyre dy qasjeve fort të ndryshme për studimet bashkëkohore të kulturës shqiptare. Natyrisht ekziston rreziku që kjo farë të mbijë një lloj ngutjeje, që e ka karakterizuar takimin ndërmjet këtyre dy qasjeve në vendet me zhvillim më të hershëm akademik, mirëpo, ngutja dhe përplasja janë pjesë përbërëse e debatit të pandalshëm akademik dhe janë shumë më të mirëpritura sesa moskomunikimi dhe mosnjohja reciproke.

Arbër Jashari  
Studiues i pavarur